



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01Nr.400 01-16234/25

Kaçanik, 22.07.2025

Procesverbal nga Konsultimi buxhetor për projekt buxhetin 2026-2027 me OJQ dhe Klubet Sportive

Vendi: Palestra Sportive- Kaçanik

Ora 13:00

Data: 22.07.2025

Fillimisht nënkryetari i Komunës së Kaçanikut Sabedin Vishi hapi takimin, duke i kërkuar të pranishmëve që të paraqesin kërkesat e tyre, që më pas në bazë të shqyrtimeve edhe do të mund të realizohen. Nënkryetari tha se shuma e subvencioneve për vitin 2026 për kulturë, rini e sport është në vlerë 110 mijë euro.

Poashtu me buxhetin komunal janë paraparë edhe shumë projekte si sigurim i terreneve sportive, kulturore e aktivitete të tjera. Nënkryetari poashtu i falenderoi OJQ -të dhe Klubet Sportive për punën dhe angazhimin e tyre në lëminë e sportit dhe kulturës.

Roland Raka- Bonnevet- Fillimisht ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe përkrahjen e komunës ndaj organizatës sonë, ndërsa kemi kërkesë që të na siguron një lokal, një që na keni propozuar është hapësirë e vogël sepse na nevojitet hapësira e madhe prej 300 metrave katror.

Shpat Bulica-Si KVRL kemi projekte të mira, falënderojmë ekzekutivin që çdo herë na ka hapur dyert, kërkojmë ndarjen e një buxheti specifik në bazë të ligjit të rinisë.

Kërkojmë që shërbimet administrative të organizatave të financohen, si dhe të subvencionohet bizneset START UP sidomos ato për IT. Të punohet më shumë për mbledhjen e arte fakteve për muze.

Skender Nikoci- KM “ Kaçaniku”- jemi mirënjohës për bashkëpunimin e komunës, kërkojmë ventillimin e sallës, si dhe subvencionet komunale të ndahen në bazë të sukseseve.

Xhevdet Hysa- SHKA “ Tingujt e Vendlindjes” Kërkojmë rritje të subvencioneve, si dhe sigurimin e një hapësire të Shtëpia e Kulturës për mbajtjen e ushtrimeve të shoqërisë sonë. .

Agron Kyqyky- Kërkojmë që të mirëmbahet salla e ushtrimeve.

Lulzim Krasniqi- Pasi që komuna i ka orientuar investimet në terrene sportive, kërkojmë që të rregullohen edhe fushat me rërë.

Emrin Dema- Si përfaqësues i organizatës “ Gjethi” ju falenderoj për bashkëpunimin dhe përkrahjen e komunës ndaj organizatës sonë.

Jonuz Bela- Kryetar i Klubit Lepenci- Ju falenderojmë për përkrahjen ndaj klubit tonë, kemi nevojë për disa klima.

Të gjithë ata që parashtruan kërkesat e tyre morën përgjigje në mënyrë të përgjithshme nga Nënkryetari i Komunës, ndërsa ditëve në vijim do të përgatitet edhe raporti me të gjitha përgjigjet për secilën kërkesë.

Takimi përfundoi në ora 14:00.

Procesmbajtëse
Fatlume Guri Selimi

